





TË DHËNAT PËR ASETIN	
Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.64	
Njësia e Vendosur në Tender Nr.28	
BVI për Mbrojtje Kundër Breshërit Lokali në Dardani	
Emri i NSh.-së	NSH "BVI për Mbrojtje Kundër Breshërit"
Lloji i shitjes	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur.
Dita e Ofertimit	Më 29.11.2023 nga ora 10:00h deri 12:00h, në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë.
Regjistrimi i Ofertuesit	Nuk ka parakualifikim
Depozita e Ofertës	15,000 Euro
Vendndodhja e Aseteve	Bulevardi Bill Klinton, SU5/7, lokali nr.1 dhe 2, Dardani, Prishtinë
<u>Përshkrimi i Aseteve</u>	BVI për Mbrojtje Kundër Breshërit Lokali në Dardani përfshinë hapësirën afariste me sipërfaqe të përgjithshme prej 116.7 m ² . Aseti gjendet në kuadër të ndërtesës shumëkatëshe afariste-banesore në Bulevardin Bill Klinton, SU5/7, lokali nr.1 dhe 2, lagjja Dardania, Prishtinë.
Ndërtesat dhe tokat	<p>Nuk ka tokë që do t'i bartet blerësit të ri.</p> <p>Lidhur me pronësinë e lokalit ekziston marrëveshja mbi bashkimin e mjeteve për ndërtimin e hapësirës afariste, e lidhur midis Ndërmarrjes Publike Banesore dhe NSH BVI për Mbrojtje Kundër Breshërit.</p> <p>Në bazë të marrëveshjes në fjalë sipërfaqja e hapësirës është 116.7 m², ndërsa, në bazë të matjeve në teren të realizuara nga zyrtarët kadastral të AKP-së dhe në bazë të projektit kryesor të ndërtesës SU5/7, sipërfaqja e përgjithshme e lokalit është 127 m².</p>
Shfrytëzuesit	Lokali afarist aktualisht është i ndarë në 3 pjesë dhe shfrytëzohet pa marrëveshje të qirasë. Lokali është në proces të lirimit.
<u>Përshkrimi i Aseteve</u>	
Asetet tjera	Nuk ka.
Detyrimet që do të barten	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.

Foto/fotot
Ose informata të tjera
Për asetet në shitje



Informatat rreth Njesisë lëndë e shitjes të prezentuar në Te Dhena nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>.

Raporti i vizitës në terren



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Raport nga vizita në teren për Njësinë BVI për Mbrojtjen Kundër Breshërit Lokalë në Dardani

Data: 19.01.2023

Vizita e njësies Njësinë BVI për Mbrojtjen Kundër Breshërit Lokalë në Dardani është bërë me 18-01.2023 ku prezent ishin zyrtarja kadastrale Blerina Kukaj dhe zyrtarja për shitje Teuta Avdiu.

Njësinë BVI për Mbrojtjen Kundër Breshërit Lokalë në Dardani përfshinë hapësirën afariste me sipërfaqe të përgjithshme prej 116.7 m². Aseti gjendet në kuadër të ndërtesës shumëkatëshe afaristo-banesore në Bulevardin Bill Clinton, SU5/7, lokali nr 1 dhe 2 lagja Dardani Prishtinë.

Në bazë të marrëveshjes mbi bashkimin e mjeteve për ndërtimin e hapësirës afariste të lidhur midis Ndërmarrjes Publike Banesore dhe Njësinë BVI për Mbrojtjen Kundër Breshërit Lokalë në Dardani, sipërfaqja e hapësirës është 116.7 m² dhe e përfshinë lokalit nr1 dhe nr.2.

Në bazë të projektit kryesor të objektit SU5/7, në kuadër të së cilës gjendet hapësira afariste në fjalë, shihet se njëra hapësirë është 63.99m² dhe në kuadër të saj gjendet tualeti me sipërfaqe prej 2.84m², ndërsa hapësira tjetër afariste ka sipërfaqe prej 52.75 m² dhe në kuadër të saj gjendet tualeti me sipërfaqe prej 4.62m².

Nga vizita e lartecekur është konstatuar si ne vijim:

- Lokali afarist është i ndërtuar nga konstruksioni i fortë,
- Lokali afarist gjendet në kuadër të objektit shumëkatësh afaristo-banesor,
- Në bazë të matjeve në terren sip. e përgjithshme është 127m²,
- Lokali afarist aktualisht është i ndarë në 3 pjesë dhe shfrytëzohet si tri hapësira të ndara afariste,
- Secili nga tre lokale ka hyrje të veçante,
- Aktualisht shfrytëzohet nga palë të panjohura.

Të bashkangjitur mund të gjeni orto-foton dhe skicën e lokalit.

Raportin e përgatitën:

Blerina Kukaj
Zyrtare Kadastrale, Zyra Rajonale Prishtinë
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Teuta Avdiu
ZOAA- Zyra Rajonale Prishtinë
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) • Zyra Regionale Prishtinë, Rr. Dritan Hoxha Nr. 55, 10 000 Prishtinë, Kosovë

* Tel: 038/ 229 889 • [WWW.AKP-KS.ORG](http://www.akp-ks.org)

Informatat

Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1090, 2059

Fax: +381 (0) 38 248 076

www.pak-ks.org

Dokumentet e Ofertimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rruga: Dritan Hoxha, nr.55

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Informatat rreth Njësisë lëndë e shitjes të prezentuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investoret potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investoret potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>.